# DËSHMI ARKIVI

**A-463250**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “O bosa, ka rënë shteti!”/ Debate të forta te ‘Ligjet’ për Vlora Hysenin! Korreshi: U cenua siguria! Boçi: Shtet me letra bakalli! Manja: T’i qëndrojmë rendit të ditës |
| ADRESA | `https://tpz.al/o-bosa-ka-rene-shteti-debate-te-forta-te-ligjet-per-vlora-hysenin-korreshi-u-cenua-siguria-boci-shtet-me-letra-bakalli-manja-t-i-qendrojme-rendit-te-dites-i333668` |
| BURIMI | tpz.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 18:58:37 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 23 shtator 2026, 09:47:22 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `071c22f677e6c12b9e02aea0f770cc627b393d7a27f3b078542a51f7eeebde0f` |
| TEKSTI | `8870ed72df1e09291134f4853cd18ce10d496217efe4cffe7ecdcab0a8e510c7` |
| PAMJA | `b6aec1d9a838f65705ec1414b3b2117f014b73552557230b0032155cdeda7416` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `4233601a96ea9dae00272a297989273295e18adf0c75b705fba92e1bade5bf3c` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/4233601a96ea9dae00272a297989273295e18adf0c75b705fba92e1bade5bf3c`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET, 23 SEPTEMBER 2026, 11:47

# "O bosa, ka rënë shteti!"/ Debate të forta te 'Ligjet' për Vlora Hysenin! Korreshi: U cenua siguria! Boçi: Shtet me letra bakalli! Manja: T'i qëndrojmë rendit të ditës

tpz.al TPZ




Arrestimi i djeshëm i Vlora Hysenit, ish drejtoreshës së SHISH, ka sjellë sot debate në Komisionin Parlamentar të Ligjeve.

Me nisjen e mbledhjes së sotme të komisionit në të cilin do të diskutohej për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, nënkryetari, Oerd Bylykbashi shprehu se në qendër të çdo diskutimi jo vetëm në komisionn e Ligjeve, por edhe në të gjitha komisionet në rend dite, duhet të jetë arrestimi i djeshëm i ish-kreut të SHISH.

Të njëjtin qëndrim me Bylykbashi ndau edhe kolegu i tij demokrat, Saimir Korreshi i cili tha:

"Ka rënë shteti sot ore, o bosa, e dini ju apo jo. Çfarë të bëjmë tani, ne të rrimë dhe të ndajmë këtu kooperativat, po, si urdhëron."

Ndërkohë kryetari i komisionit, Ulsi Manja iu kërkoi dy anëtarëve opozitarë që t'i përmbahen rendit të ditës, pasi sipas tij projektligj i paraqitur në rend dite është më i rëndësishmi për komisionin e Ligjeve.

Kurse bashkëkryetari i Komisionit të reformës, deputeti Luçiano Boçi, mes të tjerash, teksa kritikoi drejtimin e Komisionit të Ligjeve nga Manja, tha se "shteti drejtohet me letra bakalli".

Pjesë nga debati:

Bylykbashi: Ju miratuat kalendarin për një proces që është qartazi në shkelje të Kushtetutës dhe thelbësisht në kundërshtim me interesin e qytetarëve. Ne nuk patëm mbledhje dje, po në rend dite sot jo vetëm në këtë komision, por në çdo komision është skandali i djeshëm zoti kryetar. Kjo reforma, që sjellin për t'ia nxirë jetën më shumë shqiptarëve ka për sfond skandalin e djeshëm. Kreu i SHISH arrestohen nga SPAK për lidhje me krimin e organizuar. Pra

ide!

Dënimet në Hagë, midis solidaritetit njerëzor ndaj të akuzuarve dhe keqkuptimeve alla shqiptare për drejtësinë
Nga Preç Zogaj

Vendimi i Gjykatës Speciale rrëzoi arsyet për të cilat ajo ishte ngritur
Nga Mero Baze

Tej e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose kliko këtu për mënyra të tjera kontakti.

Messenger

Moti
Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama

e kuptoni sa qesharake është kjo që sillni juve. Përveç asaj që keni bërë jemi në këtë kuadër, ky shtet është i krimbur nga koka te këmbët. Ky parlament diskuton për seksin e engjëjve. Flet për gjëra të cilat, thjeshtë do t'ia bëjë më keq jetën, por ndërkohë ky parlament duhet të mblidhet dhe të thotë: ore ku është ky ekzekutiv, çfarë po ndodh në këtë vend. Si ka mundësi që krimi i organizuar në nyjet nevralgjike kryesore të shtetit. SHISH, AKSHI që bën vaki ka dhe më shumë informacion sesa SHISH për jetën e përditshme të njerëzve. Ka një impakt më të madh. Kadastra, ministritë, sistemi i prokurimit, çdo gjë, një shtet i rënë dhe them mos ja veni fajin asaj, drejtoreshës apo vetëm Ergys Agasit. Është kryeministri, ai që ka edhe konceptin e centralizimit të pushtetit, që asnjë nga ju të mos bëjë gëk. Që edhe kur të vijë ky projektligji këtu, të mos ndjeheni dhe ta votoni me kokën e ulur. Dhe ajo e djeshmja është vetëm një puçërr e sistemit që është i infektuar në të gjitha qelizat, me një emër infeksioni, Edi Rama. Kaq.

Manja: Unë mendoj që ne të ecim me rendin e ditës. Sepse nuk mendoj që ka projektligj më të rëndësishëm për komisionin tonë sesa ky i sotmi dhe nuk duhet kurrsesi që ne të ulim vlerën e kësaj mbledhje dhe këtij institucioni me veprimtarinë normale të institucioneve në një shtet demokratik. Kështu që nëse ka për procedure sugjerime për rendin e ditës, mund ta merrni fjalën, por ama, duke i qëndruar rendit.

Korreshi: Duke qenë se na njoftuat edhe ndërrimin e sallës, unë mendova se kishte ardhur Bajromi, për mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare, se ka rënë shteti. Dhe thashë po na thërret dhe ne të ligjeve tani, në mbështetje të kësaj që po bie. Ne vazhdojmë sikur nuk ka ndodhur asgjë, do ndajmë hartën thotë, kooperativa bujqësore të tipit të lartë apo të tipit të mesëm. Pra do ja heqim Lenës, do ja vëmë renës bashkitë e këto të tjerat. Tani ky kuvend a ka ndonjëherë prioritete kur bie siguria kombëtare, sot kush e ruan shtetin tonë. Bajrami dini gjë nga është, se duhet të ishte këtu në këtë sallë ku bëhen mbledhjet e Këshillit të Sigurimit Kombëtar. Të tjerat janë kot tani. Ju keni vendosur, sikur do na pyesni ne juve, do na bëni mbledhje, ky është 'zhgrrab pab', ju se sollët në komision. Tek bashkëkryetari këtë dhe po na e sillni këtu raportin, keni marr dhe televizor atje të madh, ne s'jemi për kinema këtu ore. Ka rënë shteti sot ore, o bosa, e dini ju apo jo. Ai që na mbronte nga të jashtmit dhe agjenturat është në burg se tregonte vetë dhe ai që ishte i brendshmi na çonte te krimi. Çfarë të bëjmë tani, ne të rrimë dhe të ndajmë këtu kooperativat, po, si urdhëron.

Manja: Nëse keni ardhur të gjithë që të thoni të gjitha mendimit tuaj për atë të djeshmen, unë po ju jap kohën të gjithëve nga dy minuta dhe pastaj të fillojmë me rendin e ditës, nëse është kështu. Por problemi është që kemi një projektligj shumë të rëndësishëm që shkon përtej asaj që ka ndodhur dje dhe përtej atyre që kanë sot në dorë institucionet.

**tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos**

Shiko të tjera video

AKTUALITET / 23 September 2026, 11:30

Operacioni/ Terrorizoi ish-të dashurën për 2 muaj, e rrëmbeu me forcë në makinë dhe e dhunoi, pranga 33-vjeçarit

AKTUALITET / 23 September 2026, 11:23

Vlora Hyseni u mor në pyetje më herët nga SPAK për lidhjen me Agasin, kreu i SHISH: Kam kontakte vetëm me telefon, si bashkëpunëtor i shërbimit!

AKTUALITET / 23 September 2026, 11:18

Xhafaj, kritika kreut të Agjencisë së Eficencës së Energjisë: Institucioni më jo korrekt, ju deshën 5 muaj për të kthyer përgjigje!

AKTUALITET / 23 September 2026, 10:57

'Shtet demokratik'/ Ish kreu i SHISH në arrest shtëpie, debate te 'Ligjet'! PD: Ka rënë shteti, siguria kombëtare është cenuar!

AKTUALITET / 23 September 2026, 10:49

Ministeriali/ Ministri Nufi, në Slloveni: Prioritare koordinimi sa më i ngushtë mes aleatëve e partnerëve në garantimin e mbrojtjes dhe paqes

AKTUALITET / 23 September 2026, 10:27

Punësimi/ Komisioni Evropian publikon listën me 10 profesionet e reja më të kërkuara në BE! Nga inxhinierë dhe elektricistë, deri te edukatorët

AKTUALITET / 23 September 2026, 10:09

Detaje/ Vdekja e 36-vjeçarit që u hodh nga pallati, arrestohet babai i ish bashkëjetueses së tij! Dy ditë më parë dyshohet se debatoi për ndarjen e vajzës

AKTUALITET / 23 September 2026, 09:59

VIDEO/ Ndezën zjarre në Drizë e Apoloni, dy të arrestuar në Fier! Një i tretë nën hetim

AKTUALITET / 23 September 2026, 09:52

Operacioni/ Nën vëzhgim prej 2 muajsh, arrestohet 26-vjeçari në Mamurras! I gjenden 338 doza droge, një pjesë e tyre me THC të lartë

AKTUALITET / 23 September 2026, 09:46

Precedenti/ Vlora Hyseni nuk është rasti i parë, Altin Dumani hetoi edhe ish shefin e SHISH, Fatos Klosin

AKTUALITET / 23 September 2026, 09:38

## Vjeshta erdhi/ Rrebeshe shiu dhe rënie temperaturash, ja si do të jetë moti në ditët në vijim

AKTUALITET / 23 September 2026, 09:32

## Ligji i ri në Kuvend/ Shqipëria krijon rezervën strategjike të naftës, stok për të paktën 90 ditë furnizim

AKTUALITET / 23 September 2026, 09:26

## Operacioni/ Tentuan të transportonin 6 emigrantë drejt vendeve të BE-së, arrestohen 2 persona në Sarandë

AKTUALITET / 23 September 2026, 09:20

## Çfarë strategjie do të ndjekë PD? Berisha mbledh sot Kryesinë, pas ngjarjeve të fundit

AKTUALITET / 23 September 2026, 09:16

## Renditja sipas shteteve/ Kostoja e shëndetit, 8% e shqiptarëve nuk përballojnë ekzaminimet, e dyta më e lartë në Europë

AKTUALITET / 23 September 2026, 09:10

## Vendimi/ Pas shpalljes së pafajësisë, GJKKO heq sekuestron mbi pasuritë e ish-gjyqtarit Shkëlzen Selimi

AKTUALITET / 22 September 2026, 21:58

## Zjarr në Lazarat, flakët përhapen me shpejtësi! Forcat zjarrfikëse në terren për izolimin e vatrës

AKTUALITET / 22 September 2026, 21:52

## Aksident në Lezhë, humb jetën 50-vjeçari që po udhëtonte me motor


AKTUALITET / 22 September 2026, 21:23

Përfundon faza e aplikimeve për hetues të BKH-së, 979 kandidatë për 40 pozicione të lira

AKTUALITET / 22 September 2026, 21:09

Presidenti Begaj dekreton shkarkimin e drejtueses së SHISH, Vlora Hyseni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.